

REPUBLIKA E SHQIPERISE

Nr. 2450 Repertori

DHOMA E NOTERISE VLORE

Nr. 1615 Koleksioni

NOTERE Irena BIMO



DESHMI TRASHËGIMIE LIGJORE

“ Per Trashëgimlënësin Agron Xhelo HAXHIRAJ ”

Në Vlore, sot me dt. Shtate Nentor Dymije e Shtatembedhjete (07/11/2017), une Irena BIMO, Notere e Dhomes se Notereve Vlore, me zyre noteriale ne adresen: Bulevardi “Ismail Qemali”, Lagjja “Isa Boletini”, Nr.371, mora në shqyrtim kerkesen dhe dokumentacionin që i përket:

K Ë R K U E S E: **Bukurie HAXHIRAJ**, bija e Aranit dhe Fiqirete, lindur me 29-10-1959 ne Vlore dhe me banim ne Vlore, ne adresen: lagjja: “Kushtrimi“, rruga “Kristo Negovani“, nr. 1117, madhore dhe e afte per te vepruar juridikisht, per identitetin personal te se ciles une Noterja u sigurova nepermjet Leternjofimit ID te saj me nr.personal: F96029070N, leshuar ne dt. 29/07/2009.

O B J E K T I: Kerkohet leshimi i “Deshmise se Trashegimise Ligjore” per trashegimlënesin, ish bashkeshortin e saj, te ndjerin **Agron Xhelo HAXHIRAJ**.

BAZA LIGJORE : Neni 53 i Ligjit 7829/1994 “Per Noterine” (ndryshuar me Ligjin 131/2013) dhe Neni 360 e vijues i K.Civil.

Në përfundim të shqyrtimit te kerkeses dhe dokumentacionit te paraqitur nga kërkuesja, une noterja,


V Ë R E J:

-Se nga dokumentacioni ligjor i paraqitur, rezulton se kërkuesja Bukurie HAXHIRAJ eshte bashkeshortja e trashegimlënesit, te ndjerit Agron HAXHIRAJ, prandaj në bazë të nenit 32 të Kodit të Procedurës Civile, ajo ka interes te ligjshëm në këtë kerkim, pra legjitimohet të paraqesi kërkimin para kësaj zyre noterie.

-Gjithashtu Zyra Noteriale Vlore, në bazë të nenit 46/1 të Kodit të Procedurës Civile, ka kompetencën tokësore për shqyrtimin e kërkesës, pasi vendbanimi i fundit i regjistruar i trashëgimlënësit Agron HAXHIRAJ rezulton të ketë qenë në Vlore.

-Per te percaktuar rradhen e trashegimtareve ligjore te trashëgimlënësit Agron HAXHIRAJ dhe pjesët takuese te seicilit prej tyre, une noterja iu referova nenit 318 të Kodit Civil, i cili në lidhje me përcaktimin e rradhes se trashëgimtarëve ligjore të trashëgimlënësit dhe pjesët takuese të seicilit prej tyre, bën të zbatueshëm ligjin e kohës se çeljes së trashëgimisë, referuar rregullimit ligjor në kohën e vdekjes së trashëgimlënësit te lartepmendur.

-Nga verifikimet e kryera rezulton e provuar se më dt. **02-09-2017 ka vdekur ne Vlore trashëgimlënesi Agron HAXHIRAJ**, biri i Xhelo dhe Lala, lindur me 30-10-1955 ne Vlore, me gjendje civile i **martuar** ne momentin e vdekjes, fakt që vërtetohet nga dokumenti “Çertifikate Vdekje”, leshuar ne dt. 02.10.2017 nga Zyra e Gjendjes Civile Vranisht, Njesia administrative Hore-Vranisht 425, Bashkia Himare.



-Nga pergjigja e ardhur ne rruge elektronike ne dt. 04-10-2017 nga Dhoma Kombetare e Noterise prane Zyres Noteriale Irena BIMO, lidhur me “Kerkesen me nr. 89165, dt.03-10-2017”, nuk rezulton qe trashëgimlënësi Agron Xhelo HAXHIRAJ të ketë disponuar pasurinë e tij me testament si dhe nuk eshte leshuar deshmia e trashëgimise ligjore apo testamentare e ketij trashëgimlënesi nga ndonje noter tjetër.

-Ne kushtet e mesiperme, ne bazë të nenit 317 te Kodit Civil do të zbatohet trashëgimia ligjore.

-Neni 361 i Kodit Civil i cili ka qene ne fuqi edhe ne kohën e vdekjes se trashëgimlënesit, përcakton në paragrafin e parë të tij si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë bashkëshortin dhe fëmijët me formulimin:

«Në radhë te parë thirren në trashëgim fëmijët dhe bashkëshorti i aftë ose i paaftë për punë, duke trashëguar secili në pjesë të barabarta».

-Nga permbajtja e dokumentave “Çertifikate Familjare” (gjendja familjare e vitit 2010) dhe “Çertifikate Familjare” (gjendja familjare dt. 03.09.2017, nje dite mbas vdekjes se Agron Haxhiraj), te leshuara ne dt. 02.10.2017 nga Zyra e Gjendjes Civile Vranisht, Njesia administrative Hore-Vranisht 425, Bashkia Himare, rezulton se ne gjallerine e tij trashëgimlënesi Agron HAXHIRAJ ka patur vetem nje martese, ate me bashkeshorten e tij pasjetuese Bukurie HAXHIRAJ, bija e Aranit dhe Fiqirete, lindur me 29-10-1959 ne Vlore dhe se nga kjo martese ata kane patur **2 (dy) femijet e tyre**, me te dhenat e meposhtme:

1- **Çezena HAXHIRAJ**, bija e Agron dhe Bukurie, lindur me 13-08-1989 ne Vlore dhe aktualisht me vendbanim te regjistruar ne Vranisht, Vlore, e pajisur me Pasaporte me nr. BC5249045 dhe nr. personal: I95813100H, leshuar ne dt. 14-09-2009, dhe

2-**Geri HAXHIRAJ**, biri i Agron dhe Bukurie, lindur me 20-07-1991 ne Vlore dhe aktualisht me vendbanim te regjistruar ne Vranisht, Vlore, i pajisur me nr.personal J10720116L.

-Nga dokumentat e shqyrtuara dhe te administruara prej meje noteres, rezulton se trashëgimtarët ligjor te lartepemendur kanë qenë gjallë në kohën e vdekjes së trashëgimlënësit te tyre Agron HAXHIRAJ dhe si të tillë përfshihen në rrethin e trashëgimtarëve ligjor të radhës së parë të tij.

-Nga verifikimet e kryera nuk rezulton qe ndonjë nga trashëgimtarët ligjore te rradhes se pare te sipershenuar te trashëgimlënesit Agron HAXHIRAJ të ketë hequr dorë nga trashëgimia, të jetë shpallur i padenjë për të trashëguar me vendim gjykate apo të jetë përjashtuar nga trashëgimia e ketij trashëgimlënesi.

-Gjithashtu nuk rezulton qe ne gjallerine e tij, trashëgimlënësi Agron HAXHIRAJ te kete patur martesa të tjera veç asaj te permendur me siper apo te kete patur fëmijë të tjerë jashtë martese, apo të birësuar ne ngarkim te tij.

-Kerkuesja me ka deklaruar se nuk ka trashëgimtar te tjere ligjor te rradhes se pare te trashëgimlënesit Agron HAXHIRAJ, perveç atyre te pasqyruar ne dokumentat e paraqitura prej saj.

-Për sa më siper, trashëgimtar ligjore të rradhes se pare te pasurise trashëgimore te trashëgimlënësit Agron HAXHIRAJ jane bashkeshortja e tij Bukurie HAXHIRAJ si dhe 2 (dy) femijet e tyre Çezena HAXHIRAJ dhe Geri HAXHIRAJ, të cilet e trashëgojnë pasurinë trashëgimore te trashëgimlënesit Agron HAXHIRAJ ne pjese te barabarta nga 1/3 (nje te terten) pjesë të pandare secili dhe mbartin detyrimet e saj në të njëjtën masë.

PËR KËTO ARSYE:

-Une Notere Irena BIMO, në bazë të Nenit 53 të Ligjit 7829/1994 "Per Noterine" (ndryshuar me Ligjin 131/2013) dhe në bazë të Kodit Civil,

V E N D O S A:

I-Pranimin e kërkesës së kerkueses Bukurie Aranit HAXHIRAJ.

II-Lëshimin e "Dëshmisë së Trashëgimisë Ligjore" për Trashëgimlënësin Agron HAXHIRAJ, biri i Xhelo dhe Lejla, lindur me 30-10-1955 në Vlorë dhe **vdekur në Vlorë në dt. 02-09-2017**, me gjendje civile **i martuar** në momentin e vdekjes, duke përcaktuar si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë të pasurisë së tij trashëgimore, bashkeshorten e tij si dhe 2 (dy) femijet e tyre:

- 1- Bukurie Aranit HAXHIRAJ - bashkeshortja,
- 2- Çezena Agron HAXHIRAJ - e bija dhe
- 3- Geri Agron HAXHIRAJ - i biri,

të cilet e trashëgojnë pasurinë trashëgimore të trashëgimlënësit **Agron Xhelo HAXHIRAJ në pjesë të barabarta nga 1/3 (një të tretën) pjesë të pandare secili** dhe mbartin detyrimet e saj në të njëjtën masë.

III-Shpenzimet noteriale të përcaktuara nga Urdhëri Nr. 306 datë 31.07.2013, janë në ngarkim të kerkueses dhe përbëhen nga ato për paraqitjen e kërkesës dhe lëshimin e trashëgimisë ligjore.

-U lëshua në Vlorë, më datë 07-11-2017.

N O T E R E

IRENA BIMO

